



Funded by
the European Union



AGJENCIA
KOMBËTARE
E RINISË



REPUBLIC OF ALBANIA
MINISTRY OF FINANCE
GENERAL DIRECTORATE FOR FINANCING AND
CONTRACTING OF EU, WB AND OTHER DONORS FUNDS

IPA EU4Youth Programme 2022 Reference: ACT-61341 / JAD.1030030

SHPLLJEN E THIRRJES PËR APLIKIM SI ANËTAR EKSPERT NGA SHOQËRIA CIVILE NË KOMISIONIN E VLERËSIMIT TË PROJEKTPROPOZIMEVE TË ORGANIZATAVE RINORE, ORGANIZATAVE PËR TË RINJTË DHE ORGANIZATAVE SPORTIVE PËR SKEMËN E GRANTEVE EU4YOUTH

Bazuar në Ligjin Nr. 75/2019 “Për Rininë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 681 datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR)”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 566 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së Organizatave Rinore dhe/ose Për Të Rinjtë, që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë”, i ndryshuar dhe Vendimin Nr. 196, date 26.3.2026 “Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të Kriterëve, Procedurave të Përzgjedhjes e të Shpërblimit të Anëtarëve të tij”, Ligjin Nr. 65/2022 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA III)”, i cili përcakton bazën ligjore për menaxhimin dhe zbatimin e fondeve IPA III në Shqipëri, Nenit 110 të Rregullores (EU, Euratom) 2024/2509 të Parlamentit Evropian, dhe Këshillit i datës 23 Shtator 2024 që përcakton rregullat për menaxhimin indirekt dhe përgjegjësitë përkatëse të autoriteteve kombëtare dhe institucioneve të Bashkimit Evropian, dhe Kontratën Direkte të Grantit Ref. Nr. IPA 2022/AL/1, “EU4Youth Grant Scheme”, Agjencia Kombëtare e Rinisë shpall thirrjen për aplikim si antarë ekspert (**2 ekspertë nga shoqëria civile**) nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projektpropozimeve të paraqitura nga organizatat rinore, organizatat për të rinjtë dhe organizatat sportive në Skemën e Granteve EU4Youth.

Procesi i përzgjedhjes së aplikantëve:

Procesi i përzgjedhjes së antarëve ekspert nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projektpropozimeve do të menaxhohen nga Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe do të bazohet në një proces të hapur konkurrimi. Përzgjedhja e aplikantëve do të bazohet mbi vlerësimin e kushteve dhe kriterëve të shpallura në këtë thirrje.

Bazuar në Kreun II. “Përbërja e Komisionit të Vlerësimit, Kriteret dhe Procedura e Përzgjedhjes së Anëtarëve” pika 8 të Vendimit Nr. 196, date 26.3.2026 “Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të Kriterëve, Procedurave të Përzgjedhjes e të Shpërblimit të Anëtarëve të tij”:

*AKR-ja harton termat e referencës dhe shpall thirrjen e konkurrimit për ekspertët, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga shpallja e thirrjes publike. **Thirrja publikohet në faqen e internetit të institucionit dhe qëndron e hapur për të paktën 10 (dhjetë) ditë.***



Funded by
the European Union

EU4YOUTH

AKR

AGJENCIA
KOMBËTARE
E RINISË



REPUBLIC OF ALBANIA
MINISTRY OF FINANCE
GENERAL DIRECTORATE FOR FINANCING AND
CONTRACTING OF EU, WB AND OTHER DONORS FUNDS

IPA EU4Youth Programme 2022 Reference: ACT-61341 / JAD.1030030

Bazuar në Kreun II. “Përbërja e Komisionit të Vlerësimit, Kriteret dhe Procedura e Përzgjedhjes së Anëtarëve” pika 10 të Vendimit Nr. 196, date 26.3.2026 “Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin, Funkcionimin dhe Përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të Kriterëve, Procedurave të Përzgjedhjes e të Shpërblimit të Anëtarëve të tij”:

AKR-ja bën shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të kandidatëve dhe, **brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i thirrjes së konkurrimit për ekspertë, sipas rastit, shpall fitues:**

a) **2 (dy) kandidatët** e vlerësuar me pikët më të larta, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit, të parashikuar në nënndarjen “iii”, të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij kreu. Në rastin e krijimit të vakancës, ekspertët e parë zëvendësohen nga 2 (dy) kandidatët e renditur menjëherë pas tyre.

Kriteret e aplikimit:

Anëtari, ekspert i komisionit të vlerësimit, i përcaktuar në nënndarjen “iii”, të shkronjës “a”, të pikës 1, të “Kreut II. Përbërja e Komisionit të Vlerësimit, Kriteret dhe Procedura e Përzgjedhjes së Anëtarëve”, duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

- a) të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të dytë (“Master i Shkencave” ose ekuivalent), për drejtësi, administrim publik, shkenca ekonomike apo shkenca shoqërore;
- b) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- c) të ketë mbi 10 (dhjetë) vjet përvojë pune në fushën e politikave sociale dhe rinore;
- ç) të ketë përvojë të mëparshme në vlerësimin e propozimeve të organizatave të shoqërisë civile në kuadër të thirrjeve konkurruese për financim;
- d) të ketë përvojë në përgatitjen, zbatimin, monitorimin dhe/ose vlerësimin e projekteve të financuara me fonde publike;
- dh) të ketë njohuri në fushën e politikave dhe çështjeve rinore.

Procesi i aplikimit

Kandidatët e interesuar për pozicionin e ekspertit në komisionin e vlerësimit duhet të dorëzojnë me email në adresën info@rinia.gov.al dokumentacionin, si vijon:

- a) jetëshkrimin;
- b) kopje të dokumentit të identifikimit;
- c) letërmotivimin;
- ç) vetëdeklarimin për vërtetësinë e të dhënave;
- d) kopjen e diplomës universitare;
- dh) dëshminë e penalitetit.

Afati i aplikimit:

Afati përfundimtar i dorëzimit të aplikimit është data **28.06.2026**.

Periudha e zbatimit të detyrave:



Funded by
the European Union



AGJENCIA
KOMBËTARE
E RINISË



IPA EU4Youth Programme 2022 Reference: ACT-61341 / JAD.1030030

Bazuar në Kreun III. “Organizimi, Funksonimi dhe Detyrat e Komisionit të Vlerësimit, Rastet e Mbarimit të Mandatit dhe të Lirimit nga Detyra të Anëtarëve”, pika 11 të Vendimit Nr. 196, date 26.3.2026 “Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin, Funksonimin dhe Përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të Kriteve, Procedurave të Përzgjedhjes e të Shpërblimit të Anëtarëve të tij”:

Mandati i anëtarit të komisionit të vlerësimit fillon me aktin e emërimit dhe përfundon me përfundimin e plotë të procedurës së vlerësimit për thirrjen publike përkatëse, përfshirë miratimin e listës përfundimtare të projekteve të përzgjedhura për financim.

Informacion shtesë:

Angazhimi i anëtarit ekspert nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projektpropozimeve të paraqitura nga organizatat rinore, organizatat për të rinjtë dhe organizatat sportive do të realizohet bazuar në Kreun IV. “Masa Shpërblimit”, të Vendimit Nr. 196, date 26.3.2026 “Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin, Funksonimin dhe Përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të Kriteve, Procedurave të Përzgjedhjes e të Shpërblimit të Anëtarëve të tij”. Anëtari ekspert nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit ushtron detyrën në përputhje me kuadrin rregullator të miratuar për thirrjen dhe i nënshtrohet detyrimeve ligjore të përcaktuara për konfliktin e interesit dhe konfidencialitetit të dhënave gjatë gjithë procesit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Sara Bodo